



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 10.01.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Emin Gerbeshi dhe Rasim Demiri.

Mungoi: Ganimete Musliu

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes të komisionit, të mbajtura më 16.12.2011;
3. Miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Komisionit për vitin 2012;
5. Shqyrtimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- Të nderuar anëtar, duke qenë se të gjithë nga ju e keni tashmë Rendin e Ditës, unë do të propozoj që për hir të racionalitetit të bëjmë një zhvendosje të pikave të Rendit të Ditës. Pikën 5. **Shqyrtimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme**, ta shqyrtojmë te parë në mënyrë që mediat të lirohen dhe me pas ne mund të vazhdojmë me pikat e përcaktuar ne agjendë. Propozimi u miratua nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

2. Shqyrtimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kryetari- Me pajtimin e anëtarëve të Komisionit, fillojmë shqyrtimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Forcës së Sigurisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ne si Komision jemi të obliguar ta shqyrtojmë këtë Memorandum, i cili një herë është kthyer në qershorin e vitit të kaluar, për tu ripunuar. Komisioni qysh atëherë i ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta. Ministrinë brenda një Qeverie nëse e shohin të nevojshme dhe të arsyeshme të kenë një Memorandum, mund të kenë një të tillë për atë sa ky Memorandum të jetë në harmoni me ligjet në fuqi, Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me agjendën e Ministrive përkatëse brenda Qeverisë.

Ne si Komision nuk jemi njoftuar dhe nuk kemi marrë Memorandumin në mënyrë zyrtare, e kemi marrë nga faqet zyrtare të Ministrive përkatëse, gjë që tregon se Ministrinë është dashur të jenë më të kujdesshme dhe më të përgjegjshme në këtë drejtim, në mënyrë që rregullat e funksionimit institucional dhe të bashkëpunimit mes Kuvendit dhe Qeverisë të jenë në nivelin e duhur, në mënyrë që të informohemi zyrtarisht për veprimet që ndërmarrin Ministrinë.

Duke pasur parasysh që Memorandumi është përpunuar, ne si Komision i kemi disa vërejtje, këto vërejtje do t'i paraqesim tani, në mënyrë që tua paraqesim si Komision të dyja Ministrive dhe më pas ata të bëjnë Memorandumin në harmoni me ligjet në fuqi.

Gjithashtu duhet pasur parasysh që në vitin 2010 kemi pasur Planin e Reagimit Kombëtar i cili është punuar, Strategjinë Nacionale të Sigurisë, Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, Ligjin për zjarrfikje dhe shpëtim si dhe Ligjet e tjera të cilat mundësojnë funksionim normal në rrethana emergjente.

Konsiderojmë që Memorandumi ka mundur edhe të mos bëhet duke e ditur që Ministrinë brenda një Qeverie e kanë një program të përbashkët në bazë të cilit mund të implementohen detyrat dhe obligimet e tyre si institucione qeveritare.

Megjithatë, tashmë Memorandumi është bërë dhe ne si Komision do të bëjmë vërejtje në pikat të cilat ne i konsiderojmë si të nevojshme që të shqyrtohen.

Kryetari theksoi se ndër pikat e Memorandumit që do të sugjeroja ndryshime janë:

1.7. Mbrojtje të infrastrukturës kritike (furnizuesve të ujit, telekomunikimeve, etj)

Në Memorandum fjala “etj” nënkupton edhe veprime të tjera të cilat mund të jenë jashtë kornizave ligjore, prandaj në Memorandum duhet të precizohen elementet që futen në mënyrë që palët ti respektojnë.

1.8. Kontroll në trafik (për veturat e FSK-së dhe mjeteve të tjera)

Gjithashtu edhe në këtë pikë lejon hapësirë të interpretimeve të ndryshme.

1.9. Të ndihmojë në rekonicionin e terrenit në gjetjen e personave apo mjeteve të kërkues;

Edhe në këtë pikë ka hapësirë për interpretime të ndryshme prandaj, Ministrinë përkatëse duhet ta shqyrtojë dhe të bëjnë përmirësimet e duhura.

Përveç këtyre pikave të sipërpërmendura, nuk kam vërejtje të tjera në tekstin e Memorandumit të cilat më pas do t'u dërgohen Ministrive përkatëse që të bëjnë përmirësimet.

Rexhep Selimi- theksoi që pajtohet me vërejtjet e **Kryetarit** për tekstin e Memorandumit, vërejtje teknike ose edhe logjike që i janë bërë Memorandumit. Ndër të tjera ai theksoi që duke e ditur që Memorandumet janë të parapara edhe me ligj mes Ministrive, por konsideroi që ky Memorandum i cili për herë të dytë ka ardhur në Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si një ndër Memorandumet më konfuze dhe më të përfolura në opinionin publik i cili në vend të bashkëpunimit ka sjell konfuzion dhe si i tillë duket që është një lloj çakordimi qeveritar mbi sistemin e sigurisë.

Ne si Komision do të bëjmë vërejtjet tona, por duhet pasur parasysh që Memorandumin nuk e kemi marrë në mënyrë zyrtare por nga faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjë që dëshmon se Ministrinë nënshkruese të Memorandumit nuk e kanë ndarë as me Media e as me Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Sistemit të Sigurisë.

Relacioni i krijuar mes Ministrive nënshkruese të Memorandumit dhe Komisionit tonë len shumë për tu dëshiruar në fushën e bashkëpunimit, por ne si Komision edhe pse nuk mund ti referohemi zyrtarisht ne ndajmë shqetësimin me opinionin publik, median mbi këtë çështje ku ky Memorandum ka sjell më shumë konfuzion sesa bashkëpunimin mes institucioneve nënshkruese të Memorandumit.

Po ti referohemi pikës parë të Memorandumit(I. *Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është të definoj një kornizë për bashkëveprim dhe partneritet në mes të MPB dhe MFSK*) a thua që një bashkëpunim i tillë nuk ka ekzistuar mes këtyre dy Ministrive, pra një qasje e tillë ndaj sistemit të Sigurisë nuk e ka ndihmuar pozitivisht. Në vend të një bashkëpunimi të duhur mes këtyre dy Ministrive dhe të gjitha mekanizmave të sigurisë përfshirë edhe Komisionin për Siguri sjell një amulli jo vetëm në opinionin publik por edhe në raportin e Komisionit me këto dy Ministri.

Pra, mbështesim të gjitha vërejtjet e dhëna nga **Kryetari** përfshirë edhe vërejtjet e karakterit teknik, por ajo çfarë mund të thuhet është se Ministrinë edhe për herë të dytë nuk kanë sjell një Memorandum të pranueshëm për opinionin publik dhe për Komisionin për Siguri.

Fatmir Xhelili- Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi që, frika nga kërcënimet e fatkeqësive natyrore ose të atyre të shkaktuara nga dora e njeriut janë sfida të arsyeshme qoftë për individin, shtetet ose sistemet, për këtë arsye shteti ndërmerr hapat dhe mekanizmat adekuat në mënyrë që të jetë i përgatitur qoftë për parandalimin e tyre qoftë për sanimin e situatave pas gjendjeve të tilla.

Sipas tij pyetja e cila ka shkaktuar debat është ajo se, në situata të jashtëzakonshme a do të ketë kufizim të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të lëvizjes së qytetarëve?

Pikat të cilat lejojnë hapësira të interpretimit kanë krijuar dilema se ne raste të caktuara mund të ketë keqpërdorime në fushën e të drejtave të njeriut.

Tashmë dihet se Republika e Kosovës i ka dy dokumente Strategjike në këtë fushë, Sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave dhe Plan i Kombëtar gjithashtu Kosova ka ndërtuar një sistem modern për menaxhimin e situatave emergjente të cilat funksionojnë në bazë të kompetencave të përcaktuara dhe e ka të definuar qartë rolin dhe funksionin e tyre nga niveli qendror në atë lokal dhe koordinimin e aktiviteteve të tyre.

Memorandumet kanë qenë karakteristike në periudhën e tranzicionit dhe gjatë misionit të UNMIK-ut në Kosovë, pasi për këto fusha nuk ekzistonte legjislacion adekuat për mbulimin e këtyre situatave emergjente dhe për përgjegjësit e tyre, ndërsaq sot ne kemi ligjet mbi bazën e të cilave çdo mekanizëm i shtetit tonë është i obliguar të veproj në bazë të tyre p.sh Ligji për Policinë e Kosovës, Ligji për FSK-në, Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Ligji për zjarrfikje dhe shpëtim dhe Ligji për mbrojtje nga zjarri.

Pra Memorandumi mund të konsiderohet si një lehtësues i çështjeve teknike, koordinim i aktiviteteve të instrumenteve të shtetit tonë, mirëpo sa i përket interpretimeve të ndryshme që mund të bëhen në disa pika ne sugjerojmë që këto pika të shqyrtohen në mënyrë që të evitohen interpretimet e ndryshme.

Vjollca Krasniqi- Pasi përshëndeti të pranishmit ajo theksoi që sa i përket Memorandumit të arritur mes dy Ministrive ajo ishte informuar nga mediat. Duke e ditur që këto dy Ministri funksionojnë nën ombrellën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, çështja se a do të duhet një Memorandum i tillë mendoj që po, por ajo çka është për tu çuditur është mos koordinimi i këtyre dy Ministrive me Komisionin për Siguri ndërkaq ne sot po diskutojmë që të japim sugjerime, vërejtjet tona kur në fakt zyrtarisht nuk jemi të njoftuar.

Prandaj këto dy Ministri nuk kanë raporte të harmonizuara me Kryeministrinë për arritjen e qëllimeve të tilla, dhe pajtohem me disa nga anëtarët e Komisionit se ky Memorandum ka sjell konfuzion dhe mendoj se kjo është një disharmoni mes Ministrive dhe Kryeministrit.

Anton Quni- Pas përshëndeti të pranishmit, Z.Quni bëri një përkufizim të nocionit Memorandum, ndër të tjera ai theksoi që Memorandumet zakonisht arrihen mes Shteteve, Kompanive apo Partive Politike të cilat në momentin lidhjes së Memorandumit nuk kanë ndonjë pikë reference apo ndonjë akt ligjor i cili do ti detyronte që ti përmbahen ndonjë marrëveshje, gjithashtu edhe nëse palët nënshkruese të Memorandumit nuk i përmbahen atij nuk ekzistojnë sanksione ne rastet e mos zbatimit të Memorandumit.

Në gjuhën diplomatike Memorandumi njihet si “marrëveshje xhentëlmenësh” karakteristike kanë qenë në periudhën e Luftës së Ftohtë.

Në situatën ku ne ndodhemi, brenda një Qeverie ku ekzistojnë rregullat, ligjet në bazë të cilave përcaktohen përgjegjësitë e çdo institucioni. Çfarë kuptimi mund të ketë Memorandumi në këto rrethana?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përkufizon shumë qartë misionin të drejtat dhe detyrat e FSK-së, Policisë së Kosovës, për AIK-ën, Agjensionin e shërbimeve emergjente si dhe Këshillin e Sigurisë Kombëtar.

Bazuar në Kushtetutën e RKS-së janë nxjerr një sërë ligjesh që mundësojnë funksionimin e këtyre institucioneve dhe përkufizojnë përgjegjësitë e çdo institucioni.

Sipas mendimit tim nuk e shikoj të arsyeshme një Memorandum të tillë mes MFSK-së dhe MPB, që si i tillë ti obligoj ato të bashkëpunojnë mes veti, kur kjo çështje është e rregulluar me ligjet në fuqi.

Në Memorandumin mes MFSK-së dhe MPB-së thirren në *Ligjin për FSK-në*(neni 4, 5, 6, 7 10) në të cilat nene përkufizohet roli i Presidencës, Kuvendit dhe në kuadër të tij kompetencat e Komisionit për mbikëqyrjen e Sigurisë dhe Kryeministrit, si dhe *Ligjin për Policinë e Kosovës*(neni 8), prandaj kur të hartohet ndonjë akt ligjor për bashkëpunim institucional nuk është mirë të anashkalohet Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe mos të krijohet bindja se nuk ka bashkëpunim mes institucioneve relevante të Sigurisë.

Roli i Komisionit është që të reagoj në preventivë gjatë fazës së planifikimit, kështu që roli i Komisionit gjatë hartimit të këtij Memorandumi ka qenë i nevojshëm.

Gjithashtu mendoj se, para se ne të japim qëndrimet tona, do të ishte mirë që të dy Ministrat të ftohen për të dhënë shpjegime sidomos për pikat e Memorandumit që ne i quajmë përzierje të kompetencave, prandaj mendoj se kësaj problematike duhet ti qasemi të gjithë së bashku në mënyrë që mos të krijojmë konfuzion, pasi është detyrë e jona të ushtrojmë kontroll demokratik mbi institucionet e Sigurisë.

Goran Marinković- Theksoi që Memorandumi i tillë nuk ka qenë i nevojshëm por shtoi se prania e të dy Ministrave, Ministrit të FSK-së dhe Ministrit të MPB-së në dëgjime publike është më se e nevojshme.

Kryetari- pasi ftoi të pranishmit për pyetje dhe debat, shtoi se materialin e Memorandumit mes MFSK-së dhe MPB-së i kemi marr nga faqet e internetit, duke qenë se si Komision i mbikëqyrim të dy Ministrisë është obligim i jonë që ti përcjellim këto ndryshime që duhet ti bëjnë në

Memorandum dhe pas rezultatit që mund të vijë nga Ministritë përkatëse më pas të ftojme dy Ministrat në dëgjim publik dhe në Komision.

Duke qenë se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës mbikëqyrë të dy Ministritë dhe këto duhet të përgjigjen Komisionit, por një bashkëpunim paraprak do të shërbente pozitivisht.

Rexhep Selimi- Theksoi që do të ishte e rrugës që para se ti dërgohen vërejtjet për Memorandumin Ministrive përkatëse ti kërkohej Memorandumi në mënyrë zyrtare më pas të bëhen vërejtjet të cilat u paraqiten edhe sot dhe si përmbyllje praninë e dy Ministrave për dëgjim publik pranë Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryetari- Jemi dakord që të ketë përgjigje zyrtare nga ana e Ministrive për Memorandumin përkatëse para se ne ti dërgojmë vërejtjet tona dhe më pas dëgjimi publik.

Pas një pauze të shkurtër, Komisioni vazhdoi me Rendin e Ditës.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes të komisionit, të mbajtura më 16.12.2011;

Kryetari- Pyeti të pranishmit se a ka vërejtje për Procesverbalin e mbledhjes të komisionit, të mbajtur më 16.12.2011, pasi nuk pat vërejtje nga të pranishmit Procesverbali u miratua pa vërejtje.

4. Miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2011;

Kryetari- Pyeti të pranishmit nëse kanë vërejtje për Raportin e Punës së vitit 2011 dhe propozoi që këtë Raport ta kenë dhe Mediat pasi është Raport i punës njëvjeçare.

Fatmir Xhelili- Shtoi që ky Raport përmbledh të gjithë punën e Komisionit dhe të grupeve punuese, të gjitha mbledhjeve dhe është tregues i punës kualitative të Komisionit. Gjithashtu theksoi që në Raport të përfshihen edhe numri i takimeve të grupeve punuese dhe jo vetëm numri i grupeve punuese.

Kryetari- Pas këtyre propozimeve, sugjerimeve në Raportin final do të përfshihen të gjitha këto.

Rexhep Selimi- Propozoi që në Raportin e Punës së vitit 2011, fushë veprimtaria e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës të mos jetë në përmasat që është përfshirë në Raport, por të jetë në pika më të shkurtra dhe një përshkrim i tyre, dhe të ketë përfshirje të gjithë aktivitetëve të Komisionit.

Kryetari- Theksoi që me pajtimin e të gjithë anëtarëve, fushë veprimtaria e Komisionit do të ketë një përshkrim duke i përfshirë edhe vërejtjet e karakterit teknik që u paraqiten në takim.

5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Komisionit për vitin 2012

Kryetari- Në këtë pikë të Rendit të Ditës për Shqyrtimin e Planit të Veprimit të Komisionit për vitin 2012, të përbërë nga dy dokumente ku njeri bazohet në angazhimet e Komisionit për vitin 2012 dhe tjetri Plani i veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, do të shqyrtohet dhe analizohen detyrat për këtë vit në mënyrë që të kemi objektiva të qarta.

Kryetari pyeti të pranishmit nëse kanë pyetje apo sugjerime lidhur me Planin?

Rexhep Selimi- Shtoi që duke qenë se Plani i Veprimit të Komisionit për vitin 2012 është marrë sot nga të gjithë anëtarët, propozoi që shqyrtimi i kësaj pike të shtyhet në mbledhjen e radhës së Komisionit në mënyrë që ky plan të analizohet më në detaje.

Kryetari- Pas sugjerimit të anëtarëve, Kryetari deklaroi se të gjithë pajtohen me shtyrjen e kësaj pike për mbledhjen e radhës.

Fatmir Xhelili- Shtoi që pajtohet me propozimin e anëtarëve si dhe propozoi që nga ana e administratës ti bëhet një rishikim Planit në mënyrë që të bëhet diferencimi mes kompetencave Legjislative dhe Ekzekutive dhe kërkoi që materialet ti kenë dy ditë para.

Kryetari- Siguroi që sugjerimet do të merren parasysh dhe vazhdoi me njoftimin e zhvillimeve të Komisionit për vitin e kaluar. Gjithsej 13 Ligje të aprovuara në Parlamentin e Kosovës, nga 18 Projektligje sa na kanë ardhur në Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përveç atyre që kanë kaluar, në procedurë janë:

Projektligji për Policinë, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e integruar të kufirit shtetëror dhe Projektligji për Deminim Humanitar.

Një sukses i tillë ka qenë si rezultat i kompaktësisë së bashkëpunimit.

Ndër të tjera Kryetari shtoi që ka paraparë një agjendë të Komisionit për këtë vit, ku nga java e tretë e muajit Janar të kemi takimin me Drejtorin e Policisë së Kosovës si dhe me Kryeinspektorin e Policisë, ndërkaq në javën e parë të muajit Shkurt të kemi një dëgjim publik me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe Ministrin e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, në mënyrë që të paraqesim planin e Komisionit për këtë vit, si dhe me Drejtorin e Policisë një shqyrtim të Raportit të Policisë për vitin 2011.

5. Të ndryshme

Kryetari- Pyeti të pranishmit nëse kanë diçka për të shtuar në këtë pikë, pasi nuk pati asgjë për tu shtuar e konsideroi mbledhjen e mbyllur dhe i falënderoi të pranishmit për takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi